



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.1726/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit, N.N.T “ING Projekt” me seli në Raushiq, Komuna Pejë me pronar H.D., të cilën përfaqëson sipas autorizimit L.B. avokat nga Peja, kundër të paditurve F.L.K “Shala Company” sh.p.k, rr. “Beteja e Loxhës”, me pronar M.Sh. nga Peja dhe I.L. nga fshati Kodratiq, Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat B.C. nga Peja, për fitim të pabazë, në shumën prej 47.700.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, C.nr.80/18, të datës 12.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit N.N.T “ING Projekt” me seli në Raushiq, Komuna Pejë me pronar H.D., dhe **VËRTETOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, C.nr.80/18, të datës 12.04.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit N.N.T “ING Projekt” me seli në Raushiq, Komuna Pejë me pronar H.D., me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit F.L.K “Shala Company” sh.p.k, rr. “Beteja e Loxhës”, me pronar M.Sh. nga Peja dhe I.L. nga fshati Kodratiq, Komuna Pejë, që në emër të fitimit pa bazë, t’ia paguaj paditësit shumën prej 47.700 €, apo kthimin e banesës të dhënë si kompensim, me kamatë ligjore prej 12%, nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet gjyqësore, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm, si e pa bazuar si

dhe në pikën II. të dispozitivit ka detyruar paditësit N.N.T “ING Projekt” me seli në Raushiq, Komuna Pejë me pronar H.D., që të paditurve F.L.K “ Shala Company” sh.p.k, rr. “Beteja e Loxhës”, me pronar M.Sh. nga Peja dhe I.L. nga fshati Kodratiq, Komuna Pejë, t’i paguaj shumën prej 615.00 €, në emër të shpenzimeve të procedurës, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbartimit të dhunshëm, ndërsa në pikën III ka vendosur që të refuzohet kërkesa e të paditurit , me të cilën ka kërkuar që të detyrohet paditësi , që përtej pjesë aprovuese në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguaj shumën prej 615 €, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësja për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, ankesën e paditëses ta miratojë si të bazuar, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.80/18, të datës 12.04.2021, ta prishë dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje duke kërkuar që gjykata e shkallës së parë të eliminojë të metat e këtij aktgjykimi.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala e paditur me të cilën ka propozuar që të refuzohet në tërësi ankesa e palës paditëse si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi C.nr.80/18, të datës 12.04.2021.

Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakaur e atakuar, pretendimet ankimore dhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paditësi H.D., në cilësinë e pronarit të firmës të N.N.T “ING Projekt” me seli në Raushiq, Komuna Pejë, pretendon se me të paditurin M.Sh. nga Peja pronarë i firmës F.L.K “ Shala Company” sh.p.k, rr. “Beteja e Loxhës”, kanë pas marrëveshje të përbashkët ekonomike , për blerje të materialit ndërtimor(Stiropor), dhe për borxhin e krijuar në vazhdimësi janë barazuar. Paditësi për borxhin në vlerë 141.844.00 , të paditurit M.Sh., i ka dhënë një banesë në vlerë prej 47.700€, si dhe ka paguar shumën prej 50.000€, përmes përmbartuesit privat, dhe i padituri M.Sh., është pasuruar pa bazë ligjore , me pretendim se paditësi ka paguar të njëjtin borxh dy herë dhe është dëmtuar në vlerë prej 47.700€.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar pasi ka vërtetuar që në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga këto kushte ligjore , që vërtetojnë se i padituri pa bazë ligjore kishte përfituar nga këtu paditësi.

Nga provat e pa kontestuara , rezulton e provuar se paditësi me të paditurin ishin në raporte kontraktuese. Paditësi, merret me tregti me shumicë dhe pakicë me material ndërtimor, ndërsa i padituri i parë , me shitjen e materialit ndërtimor stiropoll. Paditësi , kishte marr material ndërtimor (stiropor) pa mbulesë (veresi), të i padituri i parë , dhe borxhi i krijuar kishte arritur shumën prej 141.844.00€, dhe një pjesë të borxhit paditësi , e kishte përmbushur përmes bankës , që vërtetohet nga pasqyra e bankës , e dt. 25.03.2015, ndërsa pjesën tjetër të borxhit , i padituri, e kishte realizuar përmes urdhëresës për përmbarim, pasi që gjykata e kishte refuzuar prapësimin e debitorit /paditësit , me aktvendimin e Ep.nr.184/2017, të datës 02.03.2018, atëherë kreditori/i padituri me debitorin / paditësin, kishin arrit marrëveshje për pagesën e borxhit , të cilën borxh e kishte marr përsipër me përmbush Q10 Construction, në shumën prej 50.000.00€ , dhe kjo e fundit e kishte shlyer borxhin e kreditorit, dhe kreditori e kishte tërheq propozimin për përmbarim , marrëveshja ishte nënshkruar nga kreditori , debitori dhe marrësi i obligimit për shlyerje të borxhit (Q10 Construction) me datë 06.04.2018 , pra paditësi nuk arrit ti argumentoj gjykatës , se i padituri kishte përfituar pa bazë ligjor shumën kthimin e cilës po e kërkon me padi .

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitën e neni 194 të LMD-së, e cila përcakton se *“secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri”* dhe në rastin konkret nuk është përmbushur aplikimi i kësaj dispozite ligjore , andaj duke marr për bazë këto rrethana – këto kushte të domosdoshme që të ekzistoj pasurimi pa bazë, rrjedh së elementet të cilat karakterizojnë pasurimin pa bazë janë: zmadhimi apo rritja e pasurisë në njërën anë, zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër, lidhja shkakore në mes të zmadhimit dhe zvogëlimit të pasurisë dhe mos ekzistimi i bazës juridike. Prandaj, kjo gjykate vlerëson së i padituri nuk është pasuruar pa bazë juridike në shumën prej 47.700€.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e paditësit lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara pasi gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në provat tjera në shkresat e lëndës të elaboruara pastaj me dëgjimin e dëshmitarëve qartë dhe bindshëm u provua se paditësi e kishte fituar me punë banesën nga NTSH, Ariani, dhe të njëjtën banesë paditësi, për punë ia kishte dhënë A.O., ndërsa A.O. ia kishte dhënë po të njëjtën banesë të paditurit M.Sh., për borxh që e kishte ndaj tij, e me pëlqimin e paditësit, ndërsa i padituri M.Sh., ia kishte shitur të paditurit I.L., dëshmi të cilave gjykata në shkallë të parë me të drejtë ua fali besimin e plotë sepse përputheshin edhe me provat tjera në shkresat e lëndës të elaboruara me lartë.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.nr.1726/23 dt. 05.04.2024

KRYETARJA E KOLEGJIT,

Saranda Bogaj Sheremeti,d.v.